

Njoftim për vend vakant pune

Në kuadër të ristrukturimit të saj, Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin e **Specialist në Drejtorinë e Auditimit** një kandidat profesionist, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

Arsimimi	<ul style="list-style-type: none">• Të jetë i diplomuar në një nga degët Ekonomik, Drejtësi ose në degë të Inxhinierisë së Naftës, në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja;• Të jete i pajisur me Certifikatë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik;
Eksperiencë pune	<ul style="list-style-type: none">• Preferohet të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në profesion;• Kanë avatanzh aplikantët që kanë punuar në strukturat e Auditit të Brendshëm.
Cilësitë	<ul style="list-style-type: none">• Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre;• Te mos ketë marrë asnjë masë disiplinore apo të jetë larguar për shkaqe të pa arsyeshme nga punëdhënësit e mëparshëm;• Aftësi për të kryer analiza korrekte, në kohën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin financiar;• Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikim me gojë/shkrim, të jetë i përshtatshëm për të punuar në grup, si dhe i hapur ndaj sfidave të ndryshme që mund të lindin nga procesi i punës.• Aftësi për të trajtuar informacion konfidencial në mënyrë të ndjeshme;• Nivel i lartë integriteti, besueshmërie dhe orientimi të rezultateve;• Aftësitë kompjuterike (Paketa Microsoft Office) janë thelbësore;